

11 NËNTOR 2014

# MAShT-i Kërkon Modele për Llogaridhënie Financiare të Institucioneve Universitare Publike

SHARE:

Facebook

Twitter

Google+

MAShT i Kërkon Modele për Logaridhënie Financiare të Institucioneve Universitare 1



Jeta në Kosovë

Drejtësia në Kosovë


Gazeta JnK

Kallxo

Policia

Tema

Raporte 3496



3:05 / 3:05

YouTube

NGA  
PAULINA NUSHI

11 NËNTOR 2014

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MAShT) së bashku me institucionet e Arsimit të Lartë Publik në Kosovë, po kërkojnë mënyra të reja për financim dhe llogaridhënie për institucionet publike të arsimit të lartë në Kosovë. Në shënjestër janë vënë modelet e universitetave të Austrisë, Gjermanisë dhe Spanjës.

Për të ardhur deri te zgjidhja e një modeli më të mirë, MAShT-i me përfaqësues të institucioneve të ndryshme arsimore në vend, për tri ditë rresht do të diskutojë për mënyrën e financimit dhe ngritisë së këtyre kapaciteteve në institucionet e arsimit të lartë në vend.

Arthur Mettinger nga Universiteti i Austrisë, duke treguar për përvojën e këtij universiteti, thotë se bashkëpunimi mes Ministrisë së Arsimit dhe institucioneve të Arsimit të Lartë Publik është delikate. Por sugjeron që për tejkalimin e krizave të tilla nevojitet besim i ndërsjellë.

"Një nga mësimet që ne kemi marrë është se marrëdhënia në mes të Ministrisë dhe institucioneve të Arsimit të lartë është gjithmonë shumë delikate. Por në vitet e fundit e kemi kupuar se me qëllim të zbatimit të transparencës dhe autonomisë, krejt çka duhet është raporti i besimit mes Ministrisë dhe këtyre institucioneve, dhe kjo duhet të mësohet hap pas hapi", u shpreh ai.

Drita Kadriu, Drejtoreshë e Departamentit të Arsimit të Lartë në MAShT, fritin e kësaj tryze e sheh te nxjerra e një dokumenti strategjik, si formulë për mënyrën e financimit të institucioneve të arsimit të lartë publik.

"Projekti mbështet zbatimin e ligjit për arsimin e lartë të vitit 2011 të reformës së menaxhimit dhe autonomisë financiare, e cila do të përcaktojë është formulën e financimit në arsimin e lartë, gjithashtu do të zhvillojë një dokument strategjik i quajtur 'leta e bardhë' si dhe do të ndihmojë të realizohen marrëveshjet e performancës në arsimin e lartë", tha ajo gjatë ditës së parë të tryezës.

Ndërsa Fehmi Zylfiu nga Zyra për Financa në Ministri të Arsimit tha se deri më tash nuk ka pasur parametra të aprovuara për ndarjen e buxhetit në institucionet e arsimit të lartë. Ndërsa u shpreh



20:58H, 11 NËNTOR 20

**Ambasada e S  
Tetë Vetura Pr  
Shtetit**

Prokuroria e Shtetit komunikatë të mart donacion nga ambasada Kosovë. Ushtrees i



17:53H, 11 NËNTOR 20

**Avokati i Beti  
"Lavdérion" Pr**

Bajram Tmava, mbajtës paraqitjes së për prokurorin e ras se meriton...



17:41H, 11 NËNTOR 20

**Pasojat e Ngë  
AKP-së Mbesi**

Ngërci politik ka rez të emërimit të anët Drejtoreve të Agjene Privatizimit nga an

optimist se tashmë nuk do të jetë shumë i mundimshëm planifikimi i buxhetit për institucionet e arsimit të lartë në Kosovë.

"Mënyra automatike e ndryshimeve duhet të bëhet duke u bazuar në kostot ekonomikë për secilin fakultet, pasi që, çdo universitet i ka specifikat e veta në planifikimin e buxhetit dhe të cilat deri më tash na kanë munduar në planifikim të buxhetit", tha ai.

Tryeza "Autonomia dhe llogaridhja financiare e institucioneve publike të arsimit të lartë në Kosovë", që organizohet në kuadër të projektit "Ngritura e autonomisë dhe llogaridhënie financiare në institucionet publike të arsimit të lartë në Kosovë", do të vazhdojë nesër dhe pasnesër. Kjo tryezë është organizuar në kuadër të këtij projekti të financuar nga Komisioni Evropian përmes programit TEMPUS.

Ky është një projekt tre-vjeçar dhe realizohet me pjesëmarrjen e Universitetit të Prizrenit, atij të Pejës dhe të Prishtinës si dhe tri universitetet e ndërkombëtare, si ai i Austrisë, Gjermanisë dhe Spanjisë.

#### KOMENTO PËRMES


Facebook



17:15H, 11 NËNTOR 20

#### "Dëshmitari L Lushtaku Vra"

"Dëshmitari D" gjatë tha se në fundin e ç dëshmitar i vrasjes i...



16:42H, 11 NËNTOR 20

#### Burg Dhe Gjo Akuzuarin Që

Gjykata Themelore shqiptoi dënimin un muaj burgim efektiv gjobë në shumën...



16:31H, 11 NËNTOR 20

#### Rektori Mban Vendos Rregu

"Ata kanë të drejtë të paguhën për orë këtu ju premtoj se, mësimit..

15:32h

Korrug

SH.